



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri:

VENDIM

NDËRPRITET procedura për lëndën me numër 12-3603/1 me datë 19.07.2019 formuar pas denoncimit nga parashtrues i panjohur dorëzuar deri në KSHPK.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-3603/1 me datë 19.07.2019, nga arsyje që akuzat në lidhje me dobësitë sistematike të cilat janë detalisht të përshkruara më posht sqarimit pjesërisht janë të sakta, për çka është përgaditur analizë për dobësitë e aktit të ligjit dhe nën-ligjit dhe të njëjtat janë të publikuara, kurse akuzat tjera nuk janë të vërtetuara.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-3603/1 me datë 19.07.2019 është formuar pas denoncimit nga parashtrues i panjohur deri tek KSHPK.

Në denoncim tregohet për akuza për dyshime për procedurën e bërë joligjore për punësimin e 12 nënpunësve shtetëror në Sektorin e sapoformuar për kontrollë administrativ në Byron për furnizime publike, nëpërmjet shpalljes publike nr. 79/2019 në kuptim të asaj se është bërë ndryshime në Aktin për sistematizimit të vendeve të punës në Byron për furnizime publike me kushte të veçanta për vende të punës është caktuar niveli i kualifikimit, fakulteti adekuat me qëllim që të punësohen persona konkret në Sektorin e përmendur. Në denoncim kërkohet që të kontrollohet:

1. Kur dhe sa herë është bërë ndryshimi në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës dhe vallë e njëjta është rreptësisht e drejtuar kah personat konkret.
2. Si arriti që Ministria për shoqëri informatike dhe administratë vetëm për një ditë të jep pëlqim për ndryshim të pa parë dhe nga cilat arsyje ka lejuar që të parashikohen kualifiket profesionale joadekuate për vendet e punës në të cilat do të punojnë persona të cilët duhet të bëjnë kontroll administrativ dhe dhënie të mendimit për zbatim të procedurës me bisedime pa shpallje të shpalljes.

3. Si është bërë shpërndarja e vendeve të punës gjegjësisht si tre pozicione udhëheqëse janë paraparë për persona shqiptar dhe asnjë pozicion udhëheqës për maqedonas ose persona të etnikumeve tjera.
4. Të bëhet kontroll i mënyrës dhe kushteve nën të cilat paguhen gjashtë persona me kontratë për kohë të caktuar me 25000 deri 32000 denarë dhe si të njëjtit shfrytëzojnë pushim vjetor ose pushim mjekësor të paguar.
5. Të inspektohet se si është emëruar personi përgjegjës në Byron për furnizime publike edhe pse nuk plotëson asnjë kusht.

Me qëllim që të caktohet situata faktike dhe kontrollimi i akuzave në denoncim, KSHPK dërgoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-1833/1 me datë 28.04.2020 deri në Byron për furnizime publike me të cilën kërkohet që të dorëzohen dokumentat vijuese, dhe atë: kopje nga Rregullorja për sistematizim të vendeve të punës në Byron për furnizime publike me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për sistematizim nga viti 2016 deri në ditën e pranimit të kësaj kërkesë (iu lutemi në CD-format), kopje nga Plani vjetor për punësime gjatë vitin 2019, sqarim për caktim të kushteve të veçanta në lidhje me arsimin për vendin e punës nr. 2 nga shpallja publike nr. 79.2019 (Ndihmës-udhëheqës i Sektorit për kontroll janë caktuar kushte të veçanta – niveli i kualifikit VIA sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve të më së paku 240 kredive të mbledhura sipas EKTC ose të mbaruar shkallë VII/1 shkenca juridike, shkenca për letërsi ose shkencë për gjuhë (lingvistikë) dhe sqarim në lidhje me cilin princip është bërë shpërndarja e vendeve të punës në Sektorin për kontroll administrativ sipas përkatësisë nacionale dhe listë të të punësuarve të përkohshëm nëpërmjet agjensioneve private të punësuar ose me kontratë në vepër në vitin 2019 (emri dhe mbiemri, lënda e kontratës – detyrat e punës, kohëzgjatja e kontratës dhe vlera e neto-rrogës)

Në afatin e caktuar ligjor është dorëzuar përgjigje nga Byroja për furnizime publike

Nga analizimi i dokumentacionit të mbledhur, KSHPK e caktoi gjendjen faktike vijuese:

Gjatë analizimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit i merr parasyshë akuzat e lëndës, përgjigjet e marrura nga institucionet kompetente dhe informacione nga burime tjera, me çka e caktoi gjendjen faktike vijuese:

1. Në lidhje me akuzat në denoncimit për atë se kur dhe sa herë është bërë ndryshimi në rregulloren për sistematizim të vendeve të punës dhe vallë e njëjta është rreptësisht e drejtuar dhe vallë e njëjta udhëzon në personat konkret është vërtetuar se në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës nga viti 2016 i përputhur me miratimin e Ligjit të ri për punësime në sektorin publik dhe Ligji për nënpunës administrativ është bërë ndryshim dhe plotësim me datë 22.09.2016 në lidhje me katër vende të punës dhe duke marrë parasyshë se ajo nuk është e lidhur me akuzat pas publikimit të shpalljes nr. 79 nga viti 2019 nuk mund të vërtetohet se ajo është bërë me qëllim të perosnave konkret.

Me datë 15.03.2019 është miratur Rregullorja e re për sistematizim të vendeve të punës me të cilën parashihen 60 vende të punës, pas së cilës në lidhje me kushte e përbashkëta të veçanta mësohet se është miratur përshkak përputhje me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për nënpunës administrativ (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 11/2018) në pjesën e njohjes së gjuhëve të huaja si pjesë e provimit për nënpunës administrativ si dhe për zbatim të Ligjit të ri për furnizime publike të miratur me datë 1 Shkurt të viti 2019 dhe miratimit të

akteve nënligjore në periudhë prej gjashtë muaj pas miratimit, në lidhje me aplikimin e kompetencës Kontrollit administrativ dhe revizion.

Me datë 08.11.2019 është miratuar Rregullorja e re për organizim të brendshëm dhe Rregullorja e re për sistematizim të vendeve të punës me të cilën janë paraparë 75 vende të punës, mirëpo gjatë kësaj nuk mund të vërtetohet lidhja e miratimit të këtyre akteve me shpallje publike nr. 79 nga viti 2019 e cila është publikuar ne datë 05 Qershor të viti 2019 për plotësim të vendeve të punës në Sektorin e kontrollës.

Me datë 05.02.2020 është bërë ndryshim dhe plotësim i rregullores miratuar me datë 08.11.2019 dhe atë vetëm një vend të punës në lidhje me arsimimin dhe nuk ka të bëjë me Sektorin për kontroll dhe nuk është përfshirë në shpalljen publike nr. 79/2019.

2. Në lidhje me akuzat në denoncim se si Ministria për shoqëri informatike dhe administratë vetëm për një ditë të jep pëlqim për ndryshimet e përmendura dhe nga cilat arsye është lejuar që të parashihet kualifikimet joadekuate profesinlae për vendet e punës në të cilat do të punësohen persona që do të bëjnë kontroll administrativ dhe dhënje të mendimit për zbatimin e procedurës për bisedime pa publikim të shpalljes, për pjesën e parë të pyetjeve nuk mund të jepet përgjigje konkrete sepse as në Ligjin për punësime në sektorin publik e as në Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e përgaditjes së akteve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, si dhe përmbajtja e analizës funksionale të institucioneve në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 11 me datë 26.01.2015), nuk janë paraparë afate për dhënjën e pëlqimit. Edhe përskaj asaj që ekziston perceptimi se ka lëshime, dobësi dhe ndikim politik në këtë drejtim, prap se prap në këtë rast nuk ka elemente në denoncim që të vërtetohen dyshimet.

Në lidhje me pjesën e parë të pyetjeve në lidhje me akuzat për kualifiket e parapara joadekuate për vende të caktuara të punës në nenin 17 paragrafi 4 nga Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e përgaditjes së akteve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, si dhe përmbajtja e analizës funksionale të institucioneve në sektorin publik (Gazeta zyrtare e RM, nr. 11 me datë 26.01.2015) thuhet: 94) Lloji i arsimit të mesëm caktohet nëpërmjet theksimit të së paku një, kurse më shumë të tre fushave shkencore të cilat përputhen me përshkrimin e vendit të punës, përmbajtja në Klasifikimin Fraskativ ndërkombëtar përcaktuar në Rregulloren për normativa dhe standarde për themelim të institucioneve të larta arsimore dhe për kryerjen e veprimeve për arsimim të lartë.

Në rregulloren për sistematizim në Byron për furnizime publike ekzistojn vende të punës kur lloji i paraparë i arsimit nuk përputhet me përshkrimin e vendit të punës, mirëpo kjo është vetëmse dukuri e përgjithshme tek shumë institucione që paraqet dobësi sistematike dhe rrezik nga ndikim për vendet e punës jo të caktuar (të përgjithshme), mirëpo nga ana tjetër nuk është e paraparë mekanizëm për kontroll gjatë miratimit të pëlqimit nga MSHIA përveç për asaj që është theksuar në Rregulloren e sipërpërmendur. Çfarëdo kontrole të të gjitha detaleve nga organet vëzhguese, së pari nuk mundën duke pasë parasysh numrin e institucioneve në shtet për të cilat pëlqimi për aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim jep MSHIA kurse nga ana tjetër dhe nëse do të ishte e mundshme interpretohet si përzierje eventuale të punës në vetë institucionet.

3. Në lidhje me pyejtjen se si është bërë shpërndarja e vendeve të punës gjegjësisht si tre pozicione udhëheqëse janë paraparë për persona shqiptar dhe asnjë pozicion për maqedonas ose person

nga etnikumet tjera, përgjigjen e jep vetë plani dhe plani vjetor për vitin 2019, në përputhje me shpalljen nr. 79/2019 për plotësim të 12 vendeve të punës në Sektorin për kontroll paraparë me Ligjin e ri për furnizime publike. Në Byron për furnizime publike për momentin në shpallje publike të realizuar nga Agjensioni për administratë gjithëse të punësuar janë 25 nga të cilët 19 maqedonas, 2 shqiptarë dhe nga dy prej serbëve dhe dy nga boshnjakët.

Sipas balansimit për shpallen publike nr.79/2019 janë paraparë 8 vende të punës për maqedonas, 4 për shqiptarë ku për caktimin e vendit të punës cilit etnikum do t'i takon do të përcaktohet në shpallen e publikuar nuk është caktuar në asnjë akt juridik ose e kufizuar, që don të thotë është lënë të vendos punëdhënësi.

4. Në lidhje me kërkesën që të bëhet kontroll në mënyrën dhe kushtet me të cilat bëhet pagesa e gjashtë personave me kontratë në afat të caktuar prej 25000 deri 32000 denar si dhe të njëjtat shfrytëzojnë pushim vjetor ose pushim mjekësor me pagesë, nga informacionet e fituara nga BFP është konstatuar se në kohë të caktuar deri në dhënjen e listës deri në KSHPK në BFP në kohë të caktuar gjatë viti 2018 dhe 2019 kanë qenë të angazhuar 7 persona nga të cilët vetëm një ka pasur kontratë deri më 21.11.2020, kurse të tjerë janë pranuar në kohë të pacaktuar me shpalljen nr. 79/2019. Kjo mënyrë e punësimit të personave në kohë të caktuar është e paraparë me Ligjin për punësime në sektorin publik.
5. Në lidhje me kërkesën që ka të bëjë me atë që të analizohet se si është emëruar person përgjegjës në Byron për furnizime publike edhe pse nuk plotëson asnjë kusht, KSHPK konstaton se akuzat nuk janë vërtetuar, nga arsye që në web-faqen BFP janë publikuar informacione të karakterit publik të cilat e vërtetojnë të kundërtën e të theksuarës në denoncim.

Personat të cilat kanë ushtruar detyrën e drejtorin në BFP gjatë kohës së miratimit të akteve për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës dhe zbatimit të shpalljes publike për plotësim të 12 vendeve të punës në Sektorin për kontroll, vetëmse janë të shkarkuar nga detyra.

Duke pasë parasysh të gjithë të theksuarën më lartë, KSHPK konstaton se akuzat në lidhje me dobësitë sistematike të cilat janë detalisht të përshkruara më lartë në sqarimin pjesërisht janë të sakta, për çka është përgaditur analizë e dobësive të ligjeve dhe akteve nën-ligjore, e cila vetëmse është e publikuar, kurse akuzat tjera nuk janë vërtetuar, për çka përfundoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në këtë lëndë dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

pas mbarimit të seancës së KSHPK
punoi: m-r I.P
miratoi: N.B., anëtarë i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ
Kryetar: Biljana Ivanovska